

URDHËR
Nr. 684, datë 19.12.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KUSHTET MJEKËSORE
VETERINARE DHE TË MBARËSHTIMIT QË ZBATOHEN NË LËVIZJEN DHE
IMPORTIN E NJËTHUNDRAKËVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 51, pika 2, nenit 129, germa “c”, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kushtet mjekësore veterinarë dhe të mbarështimit që zbatohen në lëvizjen dhe importin e njëthundrakëve”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE
**MBI KUSHTET MJEKËSORE VETERINARE DHE TË MBARËSHTIMIT QË
ZBATOHEN NË LËVIZJEN DHE IMPORTIN E NJËTHUNDRAKËVE**

KAPITULLI I
Neni 1

Kjo rregullore përcakton kushtet mjekësore veterinarë dhe të mbarështimit të kafshëve të gjalla, të llojit njëthundrakë, për lëvizjen dhe importimin e tyre nga vendet e tjera.

Neni 2

Në këtë rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) “Stabiliment” është një stabiliment bujqësor ose stërvitor, në të cilin mbahen ose mbarështohen zakonisht kafshët njëthundrakë, për çdo përdorim;
- b) “Njëthundrakë” janë kafshë të egra ose të domestikuara të llojit “kua” (përfshirë edhe zebrat), specie gomari ose pasardhës që vijnë nga kryqëzimi i këtyre specieve;
- c) “Njëthundrakë të regjistruar” nënkupton çdo kafshë njëthundrakë të regjistruar, siç është e përcaktuar në nenin 11, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe rregullores nr. 221, datë 14.4.2016 “Mbi metodat e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve njëthundrakë”;
- d) “Njëthundrakë për therje” nënkupton njëthundrakë që synohen të transportohen drejtpërdrejt ose me tranzit, në thertore për therje;

e) “Njëhundrakë për mbarështim ose riprodhim” nënkupton njëhundrakë përveç atyre të përmendura në gërmat “b” dhe “d”;

f) “Vend i pastër nga sëmundja afrikane e kuajve” është një vend në të cilën nuk janë shfaqur shenja klinike, nuk ka evidencë serologjike (në njëhundrakët e pavaksinuar) dhe epidemiologjike për sëmundjen afrikane të kuajve në atë vend, për dy vitet e fundit, dhe në të cilën nuk janë kryer vaksinime kundër sëmundjes gjatë 12 muajve të fundit;

g) “Sëmundje të detyrueshme për deklarim”, janë sëmundjet e cituara në aneksin I, në të cilën janë listuar nga autoriteti kompetent veterinar dhe miratuar nga ministri, për të cilat sapo zbulohen ose dyshohet, për to njoftohet shërbimi veterinar;

h) “Pranim i përkohshëm” është pranimi i përkohshëm i njëhundrakëve të regjistruar, nga vendi i origjinës, në varësi nga gjendja shëndetësore e tyre, në vendin në të cilën ato do të transportohen, për një periudhë kohore jo më pak se 90 ditë.

KAPITULLI II RREGULLAT E LËVIZJES SË NJËTHUNDRAKËVE

Neni 3

Autorizimi i lëvizjes së njëhundrakëve në Republikën e Shqipërisë bëhet vetëm nëse ato përmbushin kushtet e hartuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje dhe nenin 72, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përbëjnë përjashtim të përgjithshëm ose të kufizuar lëvizja e njëhundrakëve të cilët:

- a) ngrihen ose mbahen, për qëllime sportive apo rekreative;
- b) marrin pjesë në ngjarje kulturore ose aktivitete të organizuara nga organet e autorizuar lokale;
- c) janë të destinuara vetëm për kullotje të përkohshme ose për punë.

Në të gjitha rastet e mësipërme duhet të njoftohet ARSHVMB, sipas nenit 52, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 4

1. Kafshët njëhundrakë kur importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk duhet të shfaqin shenja klinike të sëmundjeve infektive gjatë inspektimit. Inspektimi duhet të kryhet 48 orë para kalimit të ngarkesës në vendin e dërgimit.

2. Veterineri zyrtar duhet që në momentin e inspektimit të jetë i bindur, në bazë edhe të deklarimeve nga pronari ose rritësi i kafshës, të konstatojë se njëhundrakët kanë qenë ose jo në kontakt me njëhundrakë të tjerë, që vuajnë nga sëmundje infektive ose ngjitëse gjatë 15 ditëve të fundit, menjëherë përpara inspektimit.

3. Njëhundrakët nuk duhet të jenë të destinuar për therje, nën një program kombëtar të çrrënjësjes së sëmundjeve ngjitëse.

4. Njëhundrakët duhet të identifikohen me dokumentin e tyre të identifikimit:

a) Siç është e përcaktuar në nenin 11, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe rregullores nr. 221, datë 14.4.2016 “Mbi metodat e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve njëhundrakë”. Veterineri zyrtar duhet të pezullojë vlefshmërinë e dokumentit të identifikimit në rast se gjen raste në kundërshtim me germen “a” të këtij neni ose në nenin 5 të kësaj rregulloreje. Dokumenti i identifikimit, pas therjes së njëhundrakut të regjistruar, duhet t’i kthehet autoritetit që e ka lëshuar atë.

5. Njëhundrakët nuk duhet të vijnë nga stabilimente:

a) Ku kafshët e pranishme në fermë që janë të ekspozuar ndaj një sëmundjeje dhe nuk janë therur, periudha e ndalimit për mbajtjen e tyre në fermë duhet të jetë të paktën:

i. 6 muaj në rastin e njëthundrakëve të dyshuar për prekje nga sëmundja e butrit, duke u nisur nga data e ekspozimit apo kontaktit të mundshëm me kafshë të sëmura të butrit, duke filluar nga data e kontaktit të fundit aktual ose të mundshëm me një kafshë të sëmurë. Në rastin e një mashkulli, ndalimi i tyre do të zbatohet derisa kafsha të kastrohet;

ii. 6 muaj në rastet e sëmundjes së morves ose të encefalomyelites të kuajve, duke filluar nga dita në të cilën theren njëthundrakët të cilët vuajnë nga sëmundja në fjalë;

iii. në rastin e sëmundjes së anemisë infektive të kuajve, deri në datën në të cilën kafshët e prekura janë therur, kafshët e mbetura kanë shfaqur një reaksion negativ në dy testet *Coggins* të kryera brenda tre muajve;

iv. 6 muaj nga raportimi i rastit të fundit të sëmundjes së stomatitit vezikular;

v. 1 muaj nga raportimi i fundit të rastit të sëmundjes së rabies;

vi. 15 ditë nga raportimi i fundit të rastit të sëmundjes së antraksit.

b) Nëse të gjitha llojet e kafshëve të prekshme ndaj sëmundjeve që kanë qenë në fermë, janë therur dhe mjediset janë dezinfektuar, periudha e ndalimit do të jetë 30 ditë, duke filluar nga dita në të cilën kafshët janë therur dhe mjediset janë dezinfektuar, përveç rastit të sëmundjes së antraksit, ku periudha e ndalimit është 15 ditë. Shërbimi veterinar rajonal bën përjashtim të këtyre urdhrave, në rastin e hipodromeve dhe garave.

6. Në rastin ku autoriteti kompetent harton një program vullnetar ose të detyrueshëm për sëmundjet të caktuara, nga e cila njëthundrakët janë të prekshëm, ky program duhet të ketë informacion, për:

a) përhapjen e sëmundjes brenda territorit;

b) arsyet e hartimit të këtij programi, duke marrë në konsideratë rëndësinë e sëmundjes, kostot dhe benefitet;

c) zonën gjeografike në të cilën implementohet programi;

d) statusin e kategorive që do të zbatohen në stabilimente, standardet që do të arrihen për secilën specie dhe testet që do të përdoren ku do të aplikohen vendosmëritë e marra, standardet që duhen arritur për çdo specie dhe testet që duhet të përdoren;

e) procedurat e programit të monitorimit;

f) masat që merren në rastin kur stabilimenti humbet statusin shëndetësor;

g) masat që duhen marrë, në rastet kur rezultatet e testeve të kryera në përputhje me parashikimet e programit janë pozitive.

Neni 5

1. Mund të lëvizin kafshë njëthundrakë nga ajo pjesë e territorit, e cila nuk është e pastër nga sëmundja afrikane e kuajve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas kushteve të përcaktuara në pikat e mëposhtme të këtij neni.

2. Një pjesë e një territori duhet të konsiderohet e infektuar nga sëmundja afrikane e kuajve nëse:

a) ka evidencë klinike, seriologjike dhe epidemiologjike për praninë e sëmundjes afrikane të kuajve në dy vitet e fundit;

b) vaksinimi kundër sëmundjes afrikane të kuajve është kryer në 12 muajt e fundit.

Pjesa e territorit që konsiderohet e infektuar nga sëmundja afrikane e kuajve duhet të përfshijë një minimum:

a) të një zone mbrojtëse me rreze të paktën 100 km përreth çdo qendre ku ka ndodhur infeksioni;

b) të një zone të survejancës të paktën 50 km, përtej zonës mbrojtëse, në të cilën nuk është kryer vaksinimi për 12 muajt e fundit.

3. Të gjithë njëhundrakët e vaksinuar, të ndodhur në zonën e mbrojtjes, duhet të jenë të regjistruar.

4. Certifikata e shëndetit duhet të vërtetojë vaksinimin e njëhundrakëve.

5. Kafshët njëhundrakë mund të dërgohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëse plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) ata duhet të dërgohen vetëm gjatë periudhave të caktuara të vitit, duke marrë parasysh aktivitetin e vektorëve;

b) ata nuk duhet të shfaqin shenja klinike të sëmundjes afrikane të kuajve në ditën e inspektimit sipas nenit 4, pika 1;

c) ato duhet t'i nënshtrohen testit, për sëmundjen afrikane të kuajve dy herë, me një interval kohor të ndërmjetëm 21 dhe 30 ditë midis dy testeve, ku testimi i dytë duhet të kryhet 10 ditë para dërgimit të tyre:

i. të kenë rezultuar negative kur është kryer testi për sëmundjen afrikane të kuajve, nëse ato nuk janë vaksinuar kundër sëmundjes afrikane të kuajve;

ii. nëse nuk kanë pasur një rritje të numrit të antitropave edhe pa ju nënshtrohur vaksinimit përgjatë dy muajve të fundit.

d) Ata duhet të mbahen në stacionin e karantinës për një minimum periudhe kohore prej 40 ditësh para dërgimit të tyre;

e) Ata duhet të jenë mbrojtur nga vektorët si insektet, përgjatë periudhës së karantinës dhe gjatë transportimit nga stacioni i karantinës në vendin e destinacionit.

Neni 6

1. Njëhundrakët duhet të transportohen, sa më shpejt të jetë e mundur nga vendi i origjinës ose direkt përmes qendrës së grumbullimit, tek vendi i destinacionit me automjete ose kontejnerë të cilat janë të pastra dhe të dezinfektuara në përputhje me nenin 72, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Automjetet duhet të dizejohen në atë mënyrë që feçet e njëhundrakëve, mbeturinat ose ushqimi, të mos dalin jashtë automjetit gjatë transportit. Transporti duhet të kryhet në mënyrë të tillë ku shëndeti dhe mirëqenia e njëhundrakëve të mund të mbrohet në mënyrë efektive sipas nenit 72, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Vendi i destinacionit të njëhundrakëve mund të bëjë përjashtime në vija të përgjithshme ose të kufizuara nga kërkesat e përmendura në nenin 4, pika 5, për kafshë të cilat janë të indikuara për therje, vetëm kur certifikata shëndetësore është në përputhje me aneksin II të kësaj rregulloreje. Kur ky rregull plotësohet, njëhundrakët që janë të destinuar për therje duhet të transportohen direkt në thertoren e përcaktuar dhe të theren brenda 5 ditëve nga mbërritja në thertore.

3. Veterineri zyrtar duhet të regjistrojë numrin e identifikimit ose numrin e dokumentit të identifikimit për kafshët e therura, të vendit të dërgimit dhe t'i dërgojë autoritetit kompetent të vendit të dërgimit, një vërtetim që kafsha është therur.

Neni 7

1. Në rastin e eksportit të sigurohet që:

a) njëhundrakët të jenë të regjistruar dhe të shoqëruar me dokumentin e identifikimit e cilësuar në nenin 59 pika 2, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar dhe certifikata shëndetësore nëse ata janë të destinuar për tregti sipas aneksit II;

b) njëhundrakët që janë për mbarshtim, prodhim ose therje, gjatë transportit të duhet të shoqërohen nga certifikata e shëndetit, në përputhje me aneksin II.

2. Certifikata shëndetësore, në rastin e njëhundrakëve të regjistruar, sipas nenit 42, pika 1, dhe neni 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të përpilohet 48 orë para hyrjes së tyre në vendin e destinacionit ose ndryshe jo më vonë se dita e fundit para dërgimit të tyre, në një nga gjuhët zyrtare të vendit të dërgimit ose destinacionit. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së certifikatës shëndetësore ose vërtetimit shëndetësor është 10 ditë.

3. Certifikata shëndetësore ose vërtetimi shëndetësor duhet të përbëhet nga një fletë e vetme.

KAPITULLI III RREGULLAT E IMPORTIT TË NJËHUNDRAKËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 8

Njëhundrakët e importuar duhet të përmbushin kushtet e cituara në nenet 9 dhe 13.

Neni 9

1. Importimi i njëhundrakëve duhet të autorizohet duke marrë parasysh situatën shëndetësore dhe garancinë e dhënë nga vendi për njëhundrakët të cilët duhet të shoqërohen me një autorizim të parashikuar sipas legjislacionit në fuqi, për tu zbatuar në të gjithë territorin e vendit ose vetëm për një pjesë të territorit të tij.

2. Kur importohen kafshë njëhundrakë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të merret parasysh:

a) statusi shëndetësor i njëhundrakëve, statusi i kafshëve të tjera shtëpiake dhe të egra, me një vëmendje të veçantë mbi sëmundjet e kafshëve ekzotike si dhe aspekteve të përgjithshme të kushteve të shëndetit dhe mjedisit të vendit nga i cili importohen kafshët njëhundrakë;

b) legjislacioni i vendit importues, në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve;

c) organizimi i Autoritetit kompetent veterinar, shërbimit inspektues dhe zbatueshmëria e shërbimeve të tij inspektuese, mbikëqyrja e aktivitetit të tyre dhe mjeteve të vëna në dispozicion të tyre, duke përfshirë punonjësit dhe kapacitetet laboratorike me qëllim zbatimin efektiv në nivel kombëtar të legjislacionit në fuqi;

d) garancia që autoritetet kompetente veterinare të vendit importues mund të japin në lidhje me pajtueshmërinë e kushteve përkatëse të shëndetit të kafshëve.

e) nëse vendi importues është anëtar i Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE), rregulloret dhe shpejtësia e informacionit të dhënë nga vendi importues në lidhje me ekzistencën e sëmundjeve infektive ose ngjitëse të njëhundrakëve në territorin e tyre, veçanërisht në lidhje me sëmundjet e listuara në faqen zyrtare të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE) dhe në aneksin I të kësaj rregulloreje;

f) vendi ynë informon menjëherë vendin importues:

i. kur konfirmohet shfaqja e sëmundjeve infektive të njëhundrakëve, të listuar në aneksin I dhe çdo ndryshim që bëhet në programet e vaksinimit në lidhje me këto sëmundje brenda 24 orëve;

ii. çdo ndryshim të propozuar mbi rregullat shëndetësore kombëtare në lidhje me njëhundrakët, veçanërisht në lidhje me importimin e tyre;

iii. statusin shëndetësor veçanërisht për njëhundrakët, në intervale të rregullta, për territorin e tij;

g) ndonjë eksperiencë nga importimet e mëparshme të njëhundrakëve të gjallë nga vendet e tjera dhe rezultatet që janë marrë nga kontrolli gjatë importit;

h) rezultatet që janë marrë nga inspektimi dhe auditimet e marra nga vendet e tjera, dhe në veçanti rezultatet e vlerësimit nga autoritetet kompetente dhe raportet e paraqitura nga autoriteti kompetent për inspektimet e kryera;

i) rregullat në fuqi të një vendi importues mbi parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive, zbatueshmërinë e tyre, përfshirë këtu rregullat e importit të njëhundrakeve nga ky vend.

3. Kushtet specifike të importit do të vendosen duke pasur parasysh situatën shëndetësore të kafshëve në Republikën e Shqipërisë, specifikisht të njëhundrakëve.

Neni 10

Njëhundrakët që vijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet:

a) të jenë të lirë nga sëmundja afrikane e kuajve;

b) të jenë të lirë nga encefalomyeliti venezuelian i njëhundrakëve;

c) të jenë të pastër për 6 muajt e fundit nga sëmundja e morves dhe e butrit.

Neni 11

Përpara ditës së transportit për në Republikën e Shqipërisë, njëhundrakët duhet të kenë qëndruar pa ndërprerje në territor ose në një pjesë të atij territori, për një periudhë kohore sipas përcaktimve të nenit 10.

Njëhundrakët duhet të vijnë nga një fermë e cila ka qenë nën mbikëqyrje veterinare.

Neni 12

Importi i njëhundrakëve në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të autorizohet vetëm nëse njëhundrakët përmbushin kërkesat:

a) e shëndetit të kafshëve, në bazë të specieve dhe kategorive të njëhundrakëve, sipas procedurave të importit të vendit nga vijnë;

b) në rastin kur vendi nuk ka qenë i lirë nga sëmundja e stomatitit vezikular ose arteriti viral për 6 muajt e fundit, njëhundrakët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

i. Duhet të vijnë nga një fermë e cila ka qenë e lirë nga stomatiti vezikular për të paktën gjashtë muajt e fundit ku duhet të kenë reaguar negativisht ndaj testeve serologjike para dërgimit;

ii. në rastin e arteritit viral, meshkujt njëhundrakë duhet që të kenë reaguar negativisht ndaj testeve serologjike ose testeve të izolimit të virusit ose kundrejt ndonjë prove tjetër të njohur, e cila do të garantonte pastërtinë nga virusi.

Neni 13

1. Njëhundrakët duhet të identifikohen në përputhje me nenin 4 pika 4 dhe të jenë të shoqëruar nga certifikata shëndetësore e plotësuar nga veterineri zyrtar.

Kjo certifikate duhet:

- a) të lëshohet në ditën e ngarkimit të kafshëve për dërgim në Republikën e Shqipërisë ose në rastin e kuajve të regjistruar, në ditën e fundit para se të hyjnë në vendin e shtetit tjetër;
 - b) të përpihet në gjuhën Shqipe dhe gjuhën e vendit nga vjen;
 - c) të shoqërojnë kafshën që nga origjina e saj;
 - d) të vërtetojnë që kafshët plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje dhe ato të përcaktuara në përputhje me këtë rregullore në lidhje me importin;
 - e) të konsistojnë në një fletë të vetme;
 - f) të lëshohet për një dërgesë të vetme ose në rastin e kafshëve për therje, të jetë në përputhje me numrin e identifikimit dhe regjistrimit të këtyre kafshëve.
2. Certifikata e shëndetit duhet të hartohet në përputhje me modelin e miratuar nga ministri .

Neni 14

1. Sapo të mbërrijnë në Republikën e Shqipërisë, njëhundrakët që janë për therje duhet të dërgohen në thertore, direkt ose pas transitit përmes aprovimit të qendrës së grumbullimit në përputhje me nenin 6 dhe në përputhje me kërkesat e shëndetit të kafshëve, duhet të thehen brenda një periudhe kohore të specifikuar në nenin 12.
2. Në rastin e kushteve të veçanta të aprovuara, autoriteti kompetent që për shkaqe shëndetësore të kafshëve, cakton thertoren në të cilën duhet të dërgohen këto njëhundrakë.

Neni 15

- a) Autoriteti kompetent mund të përcaktojë importin nga një vend apo pjesë të një territori sipas specieve dhe kategorive të njëhundrakëve;
- b) Duhet të vendosen kushtet specifike për hyrjen e përkohshme në territorin e vendit tonë të njëhundrakëve të regjistruar, të njëhundrakëve të destinuar për përdorime të veçanta ose ri-futja e tyre në territorin e vendeve të destinacionit, pas eksportimit të përkohshëm;
- c) Duhet të përcaktohen kushtet për konvertimin e hyrjes së përkohshme në hyrje të përhershme bazuar në kushtet shëndetësore të njëhundrakëve;
- d) Sëmundjet e listuara në aneksin I, ekzaminohen në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV).

Neni 16

Diagnoza e sëmundjes afrikane të kuajve, testet serologjike

Metodat serologjike të përshkruara më poshtë janë enzima të lidhura me testin imunosorbent (ELISA), të bazuara në pikën 2 të Seksionit B në kapitullin 2.5.1 të manualit të testeve diagnostike dhe vaksinave në kafshët e tokës, edicioni i 2016 i adaptuar nga Asambleja Botërore e Delegatëve të OIE në maj të 2012.

Proteina virale VP7, është një antigen imunodominant i virusit të sëmundjes afrikane të kuajve (AHSV) dhe ruhet nëpërmjet 9 serotipave të AHSV. Proteinat AHSV-VP7 rekombinante kanë treguar që janë të qëndrueshme, të padëmshme dhe të përshtatshme për tu përdorur si antigen në testin ELISA, për gjetjen e antitropave të AHSV, me një shkallë të lartë sensitiviteti dhe specifiteti (Laviada et al., 1992b (1);); Maree and Paweska, 2005). Testi indirect ELISA dhe ELISA bllokuese janë dy AHS-VP7 teste ELISA të përshtatshme për diagnostikimin serologjik të sëmundjes afrikane të kuajve (AHS).

1. Testi indirect ELISA për gjetjen e antitropave të virusit të sëmundjes Afrikane të Kuajve (AHSV)

Konjugati i përdorur në këtë metodë është një peroksidaze antihorse gamma-globuline që vepron me serum in e kuajve, mushkave dhe gomarrëve. Metoda e përshkruar nga Maree & Paweska (2005) ⁽²⁾ përdor proteinën G si konjugat i cili vepron edhe me serum in e zebrave.

Antigjeni mund të sigurohet nga Qendra e Investigimit e Shëndetit të Kafshëve (CISA) Spanjë, brenda 4-6 muaj nga kërkesa e bërë.

1.1 PROCEDURA E TESTIT

1.1.1 Faza solide

1.1.1.1 Shtresat e pllakave të testit ELISA me rekombinantët AHSV-4 VP7 hollohen në një buffer karbonati/bikarbonati me pH 9,6. Pllakat inkubohen brenda natës në temperaturë 4°C.

1.1.1.2 Lani pllakat 5 herë me ujë të distiluar 0.01% (v/v) dhe 20 herë me solucion larës.

Pastroni pllakat me një material absorbent (thithës) për të hequr çdo mbetje nga larja.

1.1.1.3 Bllokoni pllakat me një kripë fosfat buferik (pbs) me pH 7.2 + 5% (w/v) qumësht i skremuar (Nestlé Dry Skim Milk TM), 200 µl , për 1 orë në temperaturën 37°C.

1.1.1.4 Hiqni solucionin bllokues dhe pastroni pllakat me material absorbues.

1.1.2 Mostrat e testit

1.1.2.1 Mostrat e serumit që do të testohen dhe serumet e kontrollit pozitiv dhe negativ hollohen 1 në 25 PBS + 5% (w/v) qumësht i skremuar + 0,05% (v / v) Tween 20, 100 µl për pus. Inkuboji për 1 orë në 37°C. Për titrimin, bëni një seri 2-herëshe hollimi nga 1 në 25 (100 µl / well), një serum për kolonën e pllakës, dhe bëni të njëjtën gjë me kontrollet pozitive dhe negative. Inkuboji për 1 orë në temperaturën 37°C.

1.1.2.2 Lani pllakat pesë herë me ujë të distiluar 0,01% (v / v), 20 herë (solucion larës). Pastroni pllakat me material absorbues për të hequr çdo mbetje nga larja e bërë.

1.1.3 Konjugati

1.1.3.1 Hidhni 100 µl/ pusët e horseradish - peroxidase (HRP)- e konjuguar me anti – horse gamma - globulinë e holluar në PBS + 5 % qumësht + 0.05 % tween 20, pH 7.2. Inkubojeni për 1 orë në temperaturën 37 °C.

1.1.3 Lajini pllakat 5 herë me ujë të vazhdueshëm të distiluar që përmban 1.01 % (v/v) Tween 20 herë (solucion larës) Prekuni pllakat butësisht në një material absorbent për të hequr mbetjet e larjes.

1.1.4 Kromogjen/substrati

1.1.4.1 Shtu 200 µl / pusët kromogjeni / solucion substrati (10 ml e 80.6 Mm DMAB (dimetilaminobenzaldehide) + 10 ml e 1.56 mM MVTH (3-methyl- 2 benzo- tiazolinë hidrazon hidrochlorid) + 5 5 µl H₂O₂).

Zhvillimi i ngjyimit stopohet duke shtuar 50 µl 3NH₂SO₄ pas 5-10 minuta (para kontrollit negativ që fillon të ngjyroset)

Mund të përdoren gjithashtu kromogjenët e tjerë si ABTS (2,2' – Azino-bis-(3- etilbenzotiazolinë- 6 acid sulfurik), TMB (tetrametil benzidinë), ose OPD (ortho- phenyldiamine).

1.1.4.2 Lexo pllakat me 600 nm (ose 620 nm).

1.2 INTERPRETIMI I REZULTATEVE

1.2.1. Llogarisni vlerën e prerjes duke shtuar 0,06 vlerës së kontrollit negativ (0,06 është devijimi standard që derivon nga një grup prej 30 serume negative).

1.2.2. Testet e mostrave që japin vlerat e absorbimit më të ulëta se ndarja janë konsideruar si negative.

1.2.3. Mostrat e testit që japin vlerat e absorbimit më të mëdha se cut-off + 0,15 konsiderohen si pozitive.

1.2.4. Mostrat e testit që japin vlera të absorbimit të ndërmjetëm konsiderohen si jokonkluzive. Në këtë rast duhet të përdoret një teknikë e dytë për të konfirmuar rezultatin.

2. Testi bllokues Elisa për gjetjen e antitropave të virusit të sëmundjes afrikane të kuajve (AHSV)

Testi ELISA bllokuese është dizenuar për të gjetur antitropat specifik të virusit të sëmundjes afrikane të kuajve, nga kafshë të çdo speciejë njëhundrae, si p.sh. kujt, zebra dhe kryqëzimet e tyre, duke parandaluar kështu problemin e specifitetit të ekperimentuar rastësisht, duke përdorur testin e ELISA indirekte.

Principi i testit është të bllokojë reagimin midis proteinës rekombinante VP7 e absorbuar (e thithur) nga pllaka e ELISA dhe konjuguesit AHS-VP7 antitrop specifik monoclonal (Mab).

Antitropi në këtë test do të bllokojë reagimin midis antigenit dhe “Mab” duke dhënë një reduktim të ngjyrosjes, sepse “Mab” drejtohet kundër VP7. Shqyrtimi do të japë një nivel të lartë sensitiviteti dhe specifiteti.

ELISA bllokuese competitive është e pranishme në treg.

2.1 Procedura e testit

2.1.1 Faza solide

2.1.1.1 Parafilmi i pllakave ELISA me 50-100 ng rekombinant AHSV-4 VP7 të holluar në buffer me karbonat / bikarbonat me pH 9,6, inkubojini natën në 4°C.

2.1.1.2 Lajini pjatat 3 herë me kripë buferike me fosfat (pbs) 1.1 x që përmban 1.135 M NaCl dhe 0.05 % (v/v) TWEEN 20 (PBST). Pastroni pllakat me një material thithës për të larguar mbetjet e mundshme që mbesin nga larja.

2.1.2 Mostrat e testit dhe kontrolli

2.1.2.1 Mostrat e serumit që do të testohen dhe serume të kontrollit pozitiv dhe negativ, hollohen 1 në 5 në një diluent që përmban 0.35 M NaCl, 0.05 % (v/v) Tween 20 dhe 0.1 Kathon, 100 µl për pus. Inkubojini për 1 orë në temperaturën 37 °C.

2.1.2.2 Lajini pllakat 5 herë në buffer me kripë fostati (PBS) 0,1 X me përmbajtje 0,135 M NaCl dhe 0,05 % (v/v) Tween 20 (PBST). Thajini pllakat me një material absorbent për të larguar çdo mbetje të mundshme nga larja.

2.1.3 Konjuguesi

2.1.3.1 Merrni 100 µl/pusetë of horseradish peroxidase- të konjuguar me Mab anti-VP7. Më parë Mab ka qenë e holluar 1/5 000 - 1/15 000 në 1/1 e një solucion e StabiliZyme Select® Stabilizer (SurModics. Reference: SZ03) në ujë të distiluar. Inkubojeni në 30 minuta në temperaturën 37 °C.

2.1.4 Lajini pllakat 5 herë me kripë buferike me fosfat (PBS) x që përmban containing 0,135 M NaCl and 0,05 % (v/v) Tween 20 (PBST). Thajini pllakat me një material absorbent për të larguar çdo mbetje të mundshme nga larja.

2.1.5 Kromogjeni/ Substrati Shtoni 100 µl/pusetë kromogen/substrate solucion, i.e. 1 ml ABTS (ABTS (2,2'- Azino- bis-[acid 3-ethylbenzothiazoline-6-sulphonic]) 5 mg/ml + 9 ml substrat buferi (0,1 M

Fosfat Citrat buffer me ph 4 që përmban 0,03 % H₂O₂) dhe inkubojeni për 10 minuta në temperaturë dhomë. Zhvillimi i ngjyrit stopohet duke shtuar 100 µl/well e 2 % (w/v) SDS (sodium dodecyl sulphate).

2.1.6 Leximi

Lexo në 405 nm në lexues ELISA.

2.2 INTERPRETIMI I REZULTATEVE

2.1.7 Përcaktoni përqindjen e bllokimit (PB) të çdo mostre duke aplikuar formulën e mëposhtme, ku ‘Abs’ qëndron për antitropat:

$$BP = \frac{\text{Abs}(\text{control}^-) - \text{Abs}(\text{sample})}{\text{Abs}(\text{control}^-) - \text{Abs}(\text{control}^+)} \times 100$$

2.1.8 Mostrat që tregojnë një vlerë BP më të lartë se 50% duhet të konsiderohen si pozitive për antitrukat e sëmundjes afrikane të kuajve AHSV.

2.1.9 Mostrat që tregojnë një vlerë BP më të ulët se 45% duhet të konsiderohen si negative për antitrukat e sëmundjes afrikane të kuajve AHSV.

2.2.4. Mostrat që tregojnë një vlerë të PB midis 45% dhe 50% duhet të konsiderohen si jokonkluzive dhe duhet të rishikohen. Nëse rezultati është përsëri jokonkluziv, kafshët duhet të rishqyrtohen në mostrat e marra jo më shpejt se dy javë pas marrjes së mostrës, që konsiderohej si jokonkluzive.

Neni 17 Identifikimi i agjentit

Reaksioni në kohë reale i zinxhirit të transkriptimit të (rRT-PCR)

Testet e identifikimit të agjentit që bazohen në metodën e zbulimit të acidit nukleik zbulojnë llojet e referencës nga nëntë serotipat e virusit të AHSV.

Metoda e përshkruar në pikën 2.1 bazohet në pikën 1.2 të seksionit B në kapitullin 2.5.1 të Manualit të Testimeve Diagnostike dhe Vaksinave për Kafshët Tokësore, botimi 2016 i miratuar nga Asambleja Botërore e Delegatëve të OIE në maj 2012.

Çdo metodë zbulimi RT-PCR e përdorur për testimin e mostrave, gjak ose shpretkë, në kontekstin e Direktivës 2009/156 / EC duhet të kryejë barazinë ose tejkalimin e ndjeshmërisë së metodologjive të përshkruara në pikën 2.

Virusi i inaktivizuar i serotipave 1–9 të zinxhirit të referencës mund të merren nga Laboratori Referues i Bashkimit Evropian ose Laboratori Referues i OIE për sëmundjen e kuajve afrikane, Algete, Spanjë.

1. Ekstraktimi i ARN- së së virusit

Për të siguruar një reagim të mirë është e nevojshme të nxjerrim nga mostra një ARN të AHSV me cilësi të lartë. Nxjerrja e acideve nukleike nga mostrat klinike mund të kryhet nga një sërë metodash të pranishme në shtëpi ose në treg.

Kitet komerciale përdorin qasje të ndryshme për izolimin e ARN. Shumica janë të bazuara në njërën nga procedurat e mëposhtme:

- nxjerrja e acideve nukleike nga fenoli-kloroform;
- absorbimi i acideve nukleike në sistemin e filtrimit;
- absorbimi i acideve nukleike me sistemin e rruazave magnetike.

Një shembull i nxjerrjes së ARN jepet më poshtë:

i. g e mostrës indore homogjenizohet në 1 ml të solucionit të denatyrar (4 M guanidium thiocyanate, 25 mM citrat natriumi, 0,1 M 2-merkaptetanoli, 0,5% sarkozil).

1.2 Pas centrifugimit, supernatantit i shtohet 1 µg ARN maja, 0,1 ml acetat natriumi 2 M Ph4, 1ml fenol dhe 0,2 ml kloroform / izoamil alkool përzierje (49/1).

1.3. Suspensioni shkundet fort dhe ftohet në akull për 15 minuta.

1.4. Pas centrifugimit, ARN e pranishme në fazën ujore është fenol i ekstraktuar, etanoli precipituar dhe ujë steril i risuspensuar.

2. Procedura RT-PCR në kohë reale

2.1. RT-PCR në kohë reale specifike për grupin nga Agüero et al., 2008 (1)

Kjo RT-PCR në kohë reale specifike për grupin ka target VP7 të AHSV që është në gjendje të zbulojë të gjitha serotipat dhe shtamet e njohura të AHSV që qarkullojnë aktualisht. Ajo ka qenë e praktikuar me rezultate shumë të mira nga laboratorët kombëtarë referentë të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian në testet e zotësisë të organizuara çdo vit nga Laboratori Referues i Bashkimit Evropian për periudhën 2009-2015. Për më tepër, në një proces gjyqësor ndërkombëtar të organizuar në vitin 2015 në kuadër të rrjetit të laboratorëve referentë të OIE, ky protokoll u rendit i lartë mes të tjerash.

Sekuena primare dhe probe për zbulimin e specieve të virusit AHSV:

- Primer primar 5'-CCA-GTA-GGC-CAG-ATC-AAC-AG-3'
- Primer i kundërt 5'-CTA-ATG-AAA-GCG-GTG-ACC-GT-3'
- Probe MGB-TaqMan 5'-FAM-GCT-AGC-AGC-CTA-CCA-CTA-MGB-3'

2.1.1 Përqendrimi i stokut primar hollohet në një përqendrim prej 8 μ M ('stoku i punës primer 8 μ M'), ndërsa është e holluar në një përqendrim prej 50 μ M ('sonda e punës 50 μ M'). Testi i pllakave provë duhet të dizenjohej dhe të jetë e ngarkuar në softuerin e makinës PCR në kohë reale. Duke përdorur paraqitjen si një udhërrëfyes, 2.5 μ l e çdo primeri srezerve, i shtohet 8 μ M çdo pus që përmban mostrat e ARN, të kontrollit pozitiv dhe /ose negativ (përqendrimi përfundimtar i primerit do të jetë 1 μ M në 20 μ l RT-PCR përzierje). Pjata mbahet në akull.

2.1.2 2 μ l e ARN të izoluar (mostrat e testit dhe kontrollit pozitiv), ose 2 μ l të ARN-së të lirë në ujë kontrollet në reksion negativ, përzier me primer të kundërt. Kjo përzierje denatyrohet me ngrohje në 95°C për 5 minuta, e ndjekur nga ftohja e shpejtë në akull për të paktën 5 minuta.

2.1.3 Një vëllim i duhur i RT-PCR master mix në kohë reale, për numrin e mostrave për t'u testuar përgatitet sipas udhëzimeve të prodhuesit. 0.1 μ l të aksioneve së hetuesit 50 μ M shtohet në çdo pus që përmban mostra të ARN (përqendrimi përfundimtar do të jetë 0.25 μ M në çdo pus që përmban mostra të ARN). 13 μ l e RT-PCR në kohë reale dhe master mix shpërndahet në çdo pus në pllakën PCR që përmbajnë primer të denaturuar dhe ARN.

2.1.4 Pllaka vendoset në një cikler termik në kohë reale, e programuar për transkriptimin e kundërt, për dedektimin e amplifikimit cDNA/fluoreshente. Kushtet e amplifikimit konsistojnë në një hap të parë të transkriptimit në 48°C për 25 minuta, i ndjekur nga 10 minuta në 95°C ('fillimi i nxehtë') dhe 40 cikle për 15 sekonda në 95°C, 35 sekonda në 55°C, 30 sekonda në 72°C (ose 40 cikle në 97°C për 2 sekonda dhe 55°C për 30 sekonda nëse përdoren reagjentët dhe termociklet që japin reagjime të shpejta). Të dhënat e fluoreshencës që merren në fund të hapit është 55°C.

2.1.5 Analiza konsiderohet e pavlefshme nëse vërehen valë amplifikimi atipik, në këtë rast analiza duhet të përsëritet.

Mostrat konsiderohen pozitive, nëse vlera Ct (numri i ciklit në të cilin ndriçimi fluoreshent i gjeneruar brenda një reaksioni kalon pragu e ndriçimit fluoreshent) është më i ulët ose i barabartë me pragu e përcaktuar Ct (35) brenda 40 cikleve PCR (Ct $\leq$ 35).

Mostrat konsiderohen jobindëse, nëse vlera Ct është më e lartë se pragu i përcaktuar Ct (35) brenda 40 cikleve PCR (Ct > 35).

Mostrat konsiderohen negative, nëse merret një kurbë horizontale amplifikimi e cila nuk kalon vijën e pragut brenda 40 cikleve të PCR.

2.2 Grupi specifik në kohë reale e RT-PCR nga Guthrie et al, 2013 (1)

RT-PCR në kohë reale, duke përdorur sondat e transferimit të energjisë me rezonancë fluorescente, përdoret (FRET) për të zbuluar acidin nukleik të AHSV.

Analiza e AHSV RT-PCR e përshkruar, është dizenuar duke përdorur sekuenca nga një shumëllojshmëri e gjerë e shtameve aktualisht në qarkullim të AHSV (Quan et al., 2010 (2)). Ai përfshin gjithashtu një test të kontrollit të jashtëm sintetik për të verifikuar funksionimin e duhur të komponentëve të analizës.

MODEL I CERTIFIKATËS TË SHËNDETT PËR KAFSHËT NJËTHUNDRAKË



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
REPUBLIC OF ALBANIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISE
HEALTH CERTIFICATE FOR TRADE OF EQUIDAE ANIMAL
CERTIFIKATA TREGËTARE PËR KAPSHITË LLOJIT TË NJËTHUNDRAKËVE

Part I : Details of consignment / Pjesa I : Detajet e dërgesës prezente	1.1. Consignor Dërguesi Name Emri Address Adresa Postal code Kodi postar		1.2. Certificate reference num Numri i referencës së Certifikatës		1.2.a. Local reference number Numri lokal referencës			
			1.3. Central competent Authority Autoriteti Kompetent Qendror					
			1.4. Local Competent Authority Autoriteti Kompetent Lokal					
	1.5. Consignee Marresi Name Emri Address Adresa Postal code Kodi postar		1.6 No (s) of related original certificates Nr. i certifikatave origjinale		No.(s) of accompanying documents Nr. i dokumenteve shoqëruese			
			1.7					
	1.8. Country of origin Shteti i origjinës		ISO code /Kodi ISO		1.9. Region of origin Rajoni i origjinës		Code Kodi	
	1.12. Place of origin/Place of harvest Vendi i origjinës/ Vendi i prodhimit Holding ☐ Ferma Assembly centre ☐ Qendra grumbullimit Other ☐ Të tjera Name Emri Address Adresa Approval number Numri i Aprovimit		1.13. Place of destination Vendi i destinacionit Holding ☐ Ferma Assembly centre ☐ Qendra grumbullimit Establishment ☐ Stabilimenti Other ☐ Të tjera Name Emri Address Adresa Postal Code Kodi postar		1.10. Country of destination Shteti i destinacionit		ISO code Kodi ISO	
	1.14. Place of loading Vendi i ngarkesës Postal Code Kodi postar		1.15. Date and time of departure Data dhe ora e nisjes		1.11. Region of destination Rajoni i destinacionit		Code Kodi	
	1.16. Means of transport Mjeti i transportit Aeroplane ☐ Aeroplan Ship ☐ Anije Road vehicle ☐ Automjet Railway wagon ☐ Hekurudhe Other ☐ Tjetër Identification : Identifikimi		1.17. Transporter Transportuesi Name Emri Address Adresa Postal code Kodi postar Approval number Numri aprovues Member State Vendi Antar		1.19. Commodity code (CN code) Kodi i mallit/artikullit (kodi HS)			
	1.18. Description of commodity Pershkrimi i mallit/artikullit				1.20. Quantity Sasia			
1.21.				1.22. Number of packages Numri i pakove				
1.23. Identification of container/Seal number Identifikimi i kontenient /numri i vules				1.24. Type of Packing Tipi i paketimit				
1.25. Commodity certified as : Mall i certifikuar si: Breeding ☐ Per mbarshitim Registered equide ☐ Njethundrakë të regjistruar Slaughter ☐ Per therje Other ☐ Të tjera								
1.26. Transit through third country ☐ Transit përmes një vendi tjetër Third country Vendi i tretë Exit point Pika e daljes Entry point Pika e hyrjes ISO code Kodi ISO Code Kodi BIP unit no: Nr. BIP unit		1.27. Transit through Member States ☐ Member State Vendi Antar Member State Vendi Antar Member State Vendi Antar Member State Vendi Antar ISO code Kodi ISO ISO code Kodi ISO ISO code Kodi ISO ISO code Kodi ISO						
1.28. Export ☐ Eksport Third country/ Vendi i tretë Exit point/ Pika e daljes ISO code Kodi ISO Code Kodi		1.29. Estimated journey time Koha e parashikuar e udhëtimit						
1.30. Route plan/ Plani i rrugës Yes/ Po ☐ No/ Jo ☐								
1.31. Identification of the commodities Identifikimi mallit Species(Scientific name) Specia (Emri shkencor)		Identification system/ Sistemi i identifikimit						

Part II : Certification / Pjesa II : Çertifikata	II.a. Certificate reference number Çertifikate me numer reference	II.b. Local reference number Nr. lokal i referencës
	II. Health information / Informacion shëndetësor I, the undersigned, certify that the animal(s) described above meets the following requirements: Une i nënshkruari, çertifikoj që kafshët e përshkruara në këtë çertifikatë plotësojnë kërkesat e mëposhtme: (a.) II.1 it/they has/have been examined today and show(s) no clinical sign of disease (2); ato / ata janë vizituar sot dhe nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të sëmundjes (2); (b.) II.2 it/they is/are not intended for slaughter under a national programme of contagious disease eradication; ato / ata nuk janë destinuar për therje nën një program kombëtar çrrënjësjejeje e ndonjë sëmundjeje infektive; either () [II.3 it/they does/do not come from the territory or part of a Member State, which is the subject of restrictions for reasons of African horse sickness;] edhe () nëse ato/atanuk vijnë nga territore ose pjesë e Vendeve Antare, të cilat janë subjekt i kufizimeve për arsye të sëmundjes Afrikane të kuajve or () [II.3 it/they come/s from the territory of a Member State, which is the subject of restrictions for reasons of African horse sickness, have remained for at least 40 days prior to dispatch in the vector proved quarantine station of.....and has/have undergone a test for the detection of antibodies to the African horse sickness virus as described in Annex IV to Directive 2009/156/ EC carried out simultaneously on blood samples taken on two occasions with an interval of between 21- and 30 days on.....(insert date) and during the 10 days prior to dispatch on.....(insert date) ose () [II.3 të vijnë nga territori i një Shteti Anëtar, i cili është subjekt i kufizimeve të sëmundjes Afrikane të kuajve, kanë mbetur për të paktën 40 ditë para dërgimit në stacionin karantinor..... dhe është kryer një test për zbulimin e antitrapave të virusit të sëmundjes Afrikane të kuajve siç përshkruhet në Aneksin IV të Direktivës 2009 / 156 / EC të kryera në të njëjtën kohë në mostrat e gjakut të marra në një interval prej 21 dhe 30 ditësh në (shënoni datën) dhe gjatë 10 ditëve para dërgimit në (shënoni datën). either () [with negative result in each case if it/they was/were not vaccinated against African horse sickness;] edhe () [kafshët kanë shfaqur një rezultat negativ nëse ato janë ose jo vaksinuar ndaj sëmundjes Afrikane të kuajve;] or () [without increase in antibody count, if it/they was/were vaccinated against African horse sickness;] ose () [nuk kanë rritje të nivelit të antitrapave, nëse kafshët janë vaksinuar ndaj sëmundjes Afrikane të kuajve;] either () [II.4. it/they/ is /are not vaccinated against African horse sickness;] edhe () [II.4. nëse është/nuk janë ndaj sëmundjes Afrikane të kuajve;]or or () [II.4. . it/they/ is /are vaccinated against African horse sickness on.....(insert date). ose (2) [II.4. nëse ai/ata është/ janë vaksinuar ndaj sëmundjes Afrikane të kuajve më.....(vendosni datën). either () [at least two months prior to certification;] edhe () [të paktën dy muaj para se të certifikohet;] or () [at least two months prior to entry into quarantine station;] ose () [të paktën dy muaj para hyrjes në stacionin e karantinës;] II.5. it/they does/do not come from (a) holding(s) which was/were subject to prohibition order(s) for animal health reasons which laid down at least of one the following conditions: II.5. ai/ajo/ato vijnë/ nuk vijnë nga (një) stabiliment/e të cilat është/janë subjekt i urdhër/ave ndalues për arsye shëndetësore të kafshëve të cilët kanë të paktën një nga kushtet e mëposhtme: either () [not all the animals on the holding of species susceptible to the diseases mentioned in points (a) to (g) hereinafter were slaughtered and the prohibition lasted at least for: ose () [jo të gjitha kafshët e stabilimentit, të specieve të prekshme nga sëmundjet e cituara në pikat (a) deri (g) të mëposhtme janë therur dhe ndaluar për të paktën : (a) In case of equidae suspected of having contracted dourine, (a) Në rast se njëthundrakët dyshohen të jenë me sëmundjen e Butrit. either () [six months beginning on the date of the last actual or possible contact with a sick or infected with <i>Trypanosoma equiperdum</i> animal;] ose () [gjashtë muaj nga data e fillimit të rastit të fundit ose kontaktit të mundshëm me një kafshë të sëmurë ose të infektuar nga <i>Trypanosoma equiperdum</i>.]	

or (2) [in the case of a stallion,until the animal is castrated;] ose (2) [në rastin e hamshorëve para se kafsha të jetë kastruar;] (a) In case of glanders, six months beginning on the day on wich the equidae suffering from the disease or subjected with positive result to a test for detection of the causative pathogen Burkholderia mallei or antibodies to that pathogen, were killed and destroyed; (a)Në rastin e sëmundjes së Morvës gjashtë muaj nga dita në të cilën njëthundrakët kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes ose kanë qënë subjekt i një testimi me rezultat pozitiv për gjetjen e patogjenit shkaktar të <i>Burkholderia mallei</i>, ose me prani antitropash për sëmundjen në fjalë, janë eliminuar ose asgjësuar. (b) In the case of equine encephalomyelitis of any type, six months beginning on the day on wich the equidae suffering from the disease have been slaughtered, except in case of West Nile virus infection where the period of six months begins on the day the infected equidae died, have been removed from the holding or fully recovered; (b)Në rastin e encefalomielitit të njëthundrakëve të çdo tipi, gjashtë muaj nga fillimi i ditës në të cilët njëthundrakët klinikisht të prekur nga sëmundja, janë therur, përveç rastit të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor , ku periudha e gjashtë muajve fillon në ditën kur njëthundrakët e infektuar kanë ngordhur, janë lëvizur nga stabilimenti ose janë shëruar. (d)In the case of infectios anaemia, until the date on wich, the infected animals having been slaughtered, the remaining animals have shown a negative reaction to a Coggins test carried out on blood samples collected on two occasions three months apart; (d) Në rastin e anemisë infektive, para datës në të cilën kafshët e infektuara janë therur, kafshët e mbetura kanë dhënë një rezultat negativ ndaj testit Coggins , të kryer nga mostrat e gjakut që janë marrë dy herë në tre muaj të ndarë. (e)In the case of vesicular stomatitis, six months from the last case; (e)Në rastin e stomatitit vezikular , gjashtë muaj nga rasti i fundit; (f) in the case of rabies, one month from the las case; (f) Në rastin e Rabies , një muaj nga rasti i fundit; (g) in the case of anthrax, 15 days from the last case;] (g) Në rastin e Antraksit, 15 ditë nga rasti i fundit;] or (2)[following cases of dourine,glanders,equine encephalomyelitis of all types, equine infectios anaemia, vesicular stomatitis, anthrax or rabies ll animals on the holding of species susceptible to the disease in question were slaughtered or killed and the prohibition lasted for 30 days, or 15 days in the case of anthrax, beginning on the day on which, following the destruction of the animals, the disinfection of the premises was satisfactorily completed;] ose (2) rastet e mësipërme të dourinës, glanderit, encefalomielitit të njëthundrakëve të të gjitha tipeve, anemia infektive e njëthundrakëve, stomatitit vezikular, antraksit ose rabies tek të gjitha kafshët e stabilimentit që janë të prekshme nga sëmundjet, janë therur ose vvarë dhe ndalimi i tyre ka zgjatur për 30 ditë, ose 15 ditë në rastin e antraksit, duke filluar nga dita në të cilën , shkatërimi ose dizinfektimi i premiseve ka qënë i kënaqshëm i plotësuar;] to the best of my knowledge, it/they has/have not been in contact with equidae suffering from an infectios or contagious disease in the 15 days prior to this declaration; për të mirë të njohurive të mia , ata kanë / nuk kanë qënë në kontakt me njëthundrakë që vuajnë nga një infeksion ose sëmundje ngjitëse në 15 ditët e para të këtij deklarimi; at the time of inspection it/they was/were fit to be transported on the intended journey in accordance with the provisions of Regulation (EC) No 1/2005 (3). në kohën e inspektimit ato ishin / ishin të përshtatshëm për t'u transportuar në udhëtimin e paraparë në përputhje me dispozitat e Rregullores (KE) Nr. 1/2005 (3)	<table border="0"> <tr> <td data-bbox="232 1186 1367 1333"> Official veterinarian or official inspector Veterineri zyrtar ose inspektori zyrtar Name (in Capital): Emri (me Kapitale) </td> <td data-bbox="232 1333 1367 1396"> Qualification and title: Kualifikimi dhe titulli </td> </tr> <tr> <td data-bbox="232 1396 1367 1459"> Local Veterinary Unit: Njesia Veterinare Lokale Date: Data: </td> <td data-bbox="232 1396 1367 1459"> N° of the related LVU Nr. LVU Signature: Firma : </td> </tr> <tr> <td data-bbox="232 1459 1367 1551"> Stamp Vula </td> <td data-bbox="232 1459 1367 1551"></td> </tr> </table>	Official veterinarian or official inspector Veterineri zyrtar ose inspektori zyrtar Name (in Capital): Emri (me Kapitale)	Qualification and title: Kualifikimi dhe titulli	Local Veterinary Unit: Njesia Veterinare Lokale Date: Data:	N° of the related LVU Nr. LVU Signature: Firma :	Stamp Vula	
Official veterinarian or official inspector Veterineri zyrtar ose inspektori zyrtar Name (in Capital): Emri (me Kapitale)	Qualification and title: Kualifikimi dhe titulli						
Local Veterinary Unit: Njesia Veterinare Lokale Date: Data:	N° of the related LVU Nr. LVU Signature: Firma :						
Stamp Vula							